



30€

**PA USHQIM ME VETE
DREKA TEK RESTORANTI YNE**

TURIZMI MES PROPAGANDËS DHE TË VËRTETËS

RAPORT MONITORIMI

Qershor 2024



AUTOR
SERONA KOLAVERI

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR DEMOCRACY

SE REPUBLICA PERBENDELE ENDOVA PER SOCIETY

www.qeverisja.qg.com.al

Tabela e përmbajtjes

HYRJE	3
1. VITI 2024 'PROVA E ZJARRIT'	4
1.2 Korrelacioni midis numrit të turistëve dhe numrit të të punësuarëve	7
1.3 Infrastruktura dhe Shërbimet	9
2. "LUFTA" ME MENAXHIMIN E MBETJEVE	11
3. NDRYSHIMET LEGJISLATIVE LIDHUR ME LIGJIN PER TURIZMIN	14
GJETJET KRYESORE	17
REKOMANDIMET	18
BIBLIOGRAFIA	19

HYRJE

Turizmi është një motor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe kulturor të Shqipërisë, duke sjellë kontribut në të ardhurat kombëtare, punësimin dhe promovimin e bukurive natyrore dhe kulturës së vendit¹. Në një kohë kur turizmi po shënon një rritje të vazhdueshme në nivel global, është koha të shqyrtojmë sfidat dhe mundësitë që Shqipëria po përjeton në këtë sektor për vitin 2024.

Ky raport synon të ofrojë një analizë të sektorit të turizmit në Shqipëri, duke identifikuar sfidat kryesore dhe duke propozuar rekomandime për adresimin e tyre. Duke u bazuar në të dhënat dhe tendencat aktuale, do të analizojmë çështjet kyçe si infrastruktura, cilësia e shërbimeve, mungesa e fuqisë punëtore, problemet e transportit, rritja e nivelit të ndotjes si dhe ndryshimet ligjore të fundit që kanë ndikim në sektorin e turizmit, por jo vetëm.

Një nga sfidat më të mëdha që Shqipëria aktualisht po përballet është përmirësimi i infrastrukturës. Rrugët, aeroportet dhe akomodimet duhet të modernizohen dhe të zgjerohen për të përmbushur kërkesat e një numri në rritje të turistëve. Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar është një tjetër çështje e rëndësishme që kërkon vëmendje. Edukimi dhe trajnimi i stafit të shërbimeve turistike është thelbësor për të ofruar një përvojë të shkëlqyer për turistët. Përmirësimi i kushteve të punës dhe ofrimi i stimuljeve për punëtorët mund të ndihmojë jo vetëm në rritjen e nivelit të standardeve në këtë sektor.

Transporti i brendshëm dhe ndërlidhja kufitare janë faktorë të tjerë kritikë për zhvillimin e turizmit. Lehtësimi i aksesit në destinacionet turistike përmes një sistemi transporti efikas dhe të besueshëm do të risë atraktivitetin e Shqipërisë si destinacion turistik.

¹ <https://lajme.rth.al/artikull/turizmi-si-nxites-i-ekonomise-nje-veshtrim-analitik-per-ndikimin-gjate-2000-2023#:~:text=Gjat%C3%AB%20dy%20dekadave%20t%C3%AB%20fundit%2C%20kontributi%20i%20sektorit,gjeneruar%20rreth%2040%20%25%20t%C3%AB%20totalit%20t%C3%AB%20eksporte%20ve.>

Rritja e nivelit të ndotjes dhe ndikimet negative të turizmit masiv janë shqetësime që kërkojnë politika të qëndrueshme. Implementimi i masave për mbrojtjen e mjedisit dhe promovimi i turizmit të qëndrueshëm janë thelbësore për të ruajtur bukuritë natyrore të vendit për brezat e ardhshëm.

Në aspektin ligjor, ndryshimet e fundit duhet të adresojnë nevojat dhe sfidat e sektorit, duke përfshirë incentivimin e investimeve dhe lehtësimin e procedurave administrative për operatorët turistikë. Në këtë kontekst, roli i qeverisë është vendimtar për të krijuar një mjedis të favorshëm për zhvillimin e turizmit. Qeveria duhet të përqëndrohet në zhvillimin e politikave që mbështesin investimet në infrastrukturë, edukimin e fuqisë punëtore dhe mbrojtjen e mjedisit. Kjo përfshin zhvillimin e planeve strategjike afatgjata që synojnë promovimin e turizmit të qëndrueshëm, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe integrimin e teknologjive të reja për të përmirësuar përvojën e turistëve.

Me qëllim përmirësimin e kushteve për turistët dhe rritjes së standardeve të Shqipërisë si destinacion turistik, ky raport ofron një analizë objektive dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e sektorit të turizmit në vend.

1. VITI 2024 “PROVA E ZJARRIT”

Kryefjalë e vitit që lamë pas ishte turizmi , i cili do vazhdojë të mbetet kryeqendër e vëmendjes dhe për këtë sezon. Sezoni turistik i viti 2023 përpos numri të lartë të vizitorëve ishte i shoqëruar dhe nga një sërë problematikash të cilat duket se do mbeten të patrajtuara dhe këtë vit. Për të arritur sukses në sezonin turistik të vitit 2024, është thelbësore të adresojmë problemet dhe sfidat që përjetuam në vitin e kaluar. Nëse sezoni i vitit 2023 u shoqërua me një numër të lartë vizitorësh, por edhe me shumë problematika të patrajtuara, është e rëndësishme të marrin masa korigjuese dhe përmirësuese për të garantuar një përvojë sa më të pozitive për turistët.

.Ky sezon turistik do jetë tregues i rëndësishëm nëse jemi përballë një suksesi internacional apo përballë një propagande të mirëstisur politike.


1.1 Përballja me fluksin turistik

Turizmi në Shqipëri ka përjetuar një rritje të ndjeshme në vitet e fundit, duke e vendosur vendin si një destinacion të preferuar për vizitorët e huaj.

Në krahasim me vitin 2023, ku Shqipëria gjithashtu pati një numër të konsiderueshëm të vizitorëve, viti 2024 parashikohet të shënojë një rritje prej 60% në numrin e flukseve hyrëse², sipas deklaratave të bëra nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në vend; ndërkohë duke konsideruar përlogaritjet e bëra nga INSTAT në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit gjatë muajit Maj 2024, rezultojnë të kenë hyrë, në territorin shqiptar, 1,606,520 shtetas shqiptar dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar një rritje me 30,6 %, krahasuar me Majin e vitit 2023. 1,615,862 shtetas shqiptarë dhe të huaj rezultojnë të kenë dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë, duke shënuar një rritje me 30,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në Maj 2024, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 632,832, duke pësuar një rritje me 20,5 %, krahasuar me Maj 2023. Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 973,688. Ky numër është rritur me 38,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. Në grafikun e paraqitur më poshtë paraqiten lëvizjet e vizitorëve në Republikën e Shqipërisë.

² <https://turizmi.gov.al/kumbaro-takim-me-prefektet-ne-prag-te-sezonit-veror-tolerance-zero-per-struktura-betoni-ne-plazhe-mobilizim-dhe-monitorim/>

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Maj 2023- Maj 2024



Burimi: INSTAT

Përpjestimi i zhdrejtë midis të dhënave të publikuara dhe projeksionit të parashikuar qeveritar dëshmon tendencat periodike të arenës politike për "përdorjen" si mjet propagandues të çdo avantazhi të këtij sektori. Gjithashtu vlen për t'u theksuar që mbetemi ndër të paktat vende që raportojmë jo turistët, por vizitorët e huaj duke përfshirë këtu shtetasit e Malit të Zi, Kosovës apo Maqedonisë së Veriut të cilët kryejnë fluturime nga aeroporti i Tiranës. Përlogaritja e turistëve tranzit si pjesë e numrit të turistëve që vendosin të vizitojnë Shqipërinë rrit marzhin e gabimit duke ulur kështu nivelin e besueshmërisë së të dhënave të publikuara.

Sektori i turizmit si mjet me ndikim të madh në opinionin publik brenda dhe jashtë vendit, duke e prezantuar Shqipërinë si një destinacion turistik tërheqës dhe duke theksuar zhvillimet pozitive në këtë sektor cdo ditë e më shumë duket se po behet pjesë e përfitimve të mazhorancës qeveritare në vend . Nisur nga raportet zyrtare dhe komunikimet publike ka rritje të numrit të turistëve dhe vizitorëve, përmes të cilave qeveria synon të përhapë imazhin e një vendi të suksesshëm dhe të hapur për turizmin jo pak herë duke dezformuar publikun.

Përgjatë 3 muajve të parë të vitit 2024 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka deklaruar se ka një rritje me 60 % të numrit të vizitorëve në vend³, duke hiperbolizuar shifrat aktuale në mënyrë që të krijojë bindje në publik rreth një suksesi të pritshëm që shkon përtej kufinjve.

Përdorimi i turizmit si një mjet propagandistik sjell një përshtypje të rreme përpara publikut. Në jo pak raste, raportimi i rritjes së numrit të vizitorëve duke përfshirë edhe shtetas të vendeve fqinje si turistë, çon në krijimin e një imazhi të pavërtetë të impaktit të turizmit në ekonominë dhe kulturën e vendit. Ky në vetvete është një tregues i rëndësishëm lidhur me vlerësimin objektiv të të dhënave për të kuptuar se si politikat qeveritare në sektorin e turizmit ndikojnë në zhvillimin e vendit dhe në perceptimin internacional të Shqipërisë shpeshherë në konotacion negativ.

1.2 Korrelacioni midis numrit të turistëve dhe numrit të të punësuarëve

Menaxhimi i fluksit turistik është një sfidë komplekse që përfshin koordinimin ndërmjet autoriteteve lokale dhe bizneseve, gjithashtu përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e kapaciteteve, trajnimin e stafit dhe implementimin e teknologjive të reja për të siguruar një përvojë sa më pozitive për turistët. A po zhvillojnë autoritetet strategji të qarta për menaxhimin e fluksit, të cilat mund të përfshijnë promovimin e turizmit jashtë sezonit për të shmangur mbingarkesën në periudha piku?


Në një vend si Shqipëria, turizmi është një sektor kyç për ekonominë dhe punësimin, por përshtatja e numrit të të punësuarëve me fluksin e turistëve duket se është kthyer në sfidë.

Në rastin e rritjes së numrit të turistëve, kërkesa për shërbime, si akomodimi, ushqimi, transporti, dhe argëtimi rritet ndjeshëm. Kjo nënkupton se nevoja për të punësuar më shumë njerëz është e detyrueshme për të përballuar kërkesën e rritur të shërbimeve.

³ <https://turizmi.gov.al/kumbaro-takim-me-prefektet-ne-prag-te-sezonit-veror-tolerance-zero-per-struktura-betoni-ne-plazhe-mobilizim-dhe-monitorim/>

Një nga problematikat kryesore me të cilat përballet sektori i turizmit në Shqipëri është mungesa e korrelacionit midis numrit të turistëve dhe numrit të të punësuarve në këtë sektor. Ndërsa numri i turistëve po rritet ndjeshëm, numri i të punësuarve nuk po rritet në të njëjtën shkallë.

Fig.2 : Numri i vizitorëve dhe numri i të punësuarëve përgjatë vitit 2023



Burimi : Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të pritur dhe përcjellë mbi 9.5 milionë turistë në vitin 2023, kishte më pak se 58 mijë të punësuar në këtë sektor. Kjo nënkupton se një punonjës i turizmit në Shqipëri duhet t'u shërbejë një numri të madh turistësh. Nëse raporti midis numrit të të punësuarve dhe numrit të vizitorëve vazhdon të mbetet në përpjestim të zhdrejtë, fluksi turistik i këtij viti i parashikuar me një rritje prej 30% do të krijojë presion mbi infrastrukturën ekzistuese dhe të krijojë vështirësi akoma më të mëdha për punonjësit aktualë të sektorit të turizmit.

Gjithashtu përshtatja e numrit të të punësuarëve me karakteristikat e sezonalitetit të turizmit mbetet një sfidë tjetër. Në periudha të caktuara të vitit, si verë apo periudha festive, kërkesa për shërbime rritet shumë, duke krijuar nevojë për të punësuar personel shtesë për të përballuar këtë kërkesë të rritur. Megjithatë, pas këtyre periudhave, ka një ulje drastike në kërkesën për shërbime, duke çuar në nevojën për zvogëlimin e numrit të të punësuarëve. Rahman Kasa, kreu i Unionit Turistik Shqiptar ka theksuar shpeshherë se numri i turistëve po rritet ndërsa numri i burimeve njerëzore zvogëlohet atëherë rrjedhimisht këto

shërbime mbeten pa përgjigje. Kjo mungesë e përgjigjeve do sjellë rënie drastike të numrit të turistëve.

Mungesa e fuqisë punëtore është një problem i madh që kërkon zgjidhje të menjëhershme. Punonjësit në sektorin e turizmit shpesh përballen me kushte të vështira pune dhe paga të ulëta, gjë që e bën të vështirë mbajtjen e stafit të kualifikuar. Për të përmirësuar situatën, është e nevojshme të investohet në trajnimin dhe zhvillimin e stafit, si dhe të përmirësohen kushtet e punës. Kjo do të ndihmojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe në tërheqjen e më shumë turistëve.

1.3 Infrastruktura dhe Shërbimet

Infrastruktura është një komponent kyç për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Shqipëria ka nevojë për përmirësime të mëdha në infrastrukturën rrugore, të transportit dhe të akomodimit për të përballuar numrin e madh të turistëve që pritet të vizitojnë vendin në vitin 2024. Shumë rrugë janë të ngarkuara dhe nuk mund të përballojnë flukset e mëdha të trafikut, gjë që mund të krijojë vonesa dhe shqetësime për turistët.

Bumi turistik i shënuar gjatë sezonit veror të vitit të kaluar nxorri në pah jo pak problematika që duhen adresuar për zgjidhje mes te tjerash dhe shtimi i faciliteteve. Nisur nga sezoni turistik i vitit 2023 shumë kompani nuk kanë arritur dot të sigurojnë hapësira akomoduese për shkak të mungesës së njësive akomoduese.

Një tjetër shqetësim i ngritur nga unioni turistik shqiptar është shfrytëzimi jo proporcional i vijës bregdetare. Sipas Rraman Kasës, disa pika janë të mbipopulluara ndërkohë shume zona potenciale mbeten të paeksploruara si Semani, Darëzeza, Spilleja etc. Disproporcionaliteti midis shpërndarjes së zonave turistike duke e centralizuar vëmendjen ne 4-5 pika , ka sjellë jo vetëm mbipopullim të këtyre zonave, por në të njëjtën kohë mosshfrytëzim të vijës bregdetare në menyrë të balancuar .

Pavarësisht investimeve në infrastrukturë, në shumë rajone sipas Kasës është i nevojshëm një rrjet më i mirë rrugor, sidomos në veri, por edhe aksi Tiranë – Durrës mbetet problematik. Në kontekstin e vendeve fqinje, ka shembuj të praktikave të mira dhe zgjidhjeve të gjetura për të adresuar problematikat e infrastrukturës dhe shërbimeve. Për shembull, vendet e rajonit si Kroacia dhe Greqia kanë investuar në modernizimin e infrastrukturës së tyre në mënyrë të ndjeshme.

Kroacia, si një destinacion turistik i njohur në Ballkan, ka përmirësuar aeroportet dhe ka zhvilluar sisteme të avancuara të transportit publik për të lehtësuar lëvizjen e udhëtarëve. Në të njëjtën kohë, ka ndërtuar dhe rikonstruktuar hotele dhe struktura të tjera akomoduese për të përballuar kërkesën e rritur turistike.

Greqia, një destinacion turistik i rëndësishëm në Evropë, ka investuar në modernizimin e infrastrukturës rrugore dhe të transportit. Përmirësimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve të transportit publik ka ndihmuar në lehtësimin e lëvizjes së vizitorëve brenda vendit dhe në destinacionet turistike.

Përveç kësaj, vende si **Turqia dhe Maqedonia** kanë përdorur modelin e partneritetit publik-privat për të zhvilluar infrastrukturën. Këto vende kanë bërë investime të rëndësishme në ndërtimin e aeroporteve të reja dhe në modernizimin e infrastrukturës së rrugëve për të përballuar numrin e madh të turistëve.

Kjo tregon se ka shembuj të suksesshëm që Shqipëria mund të ndjekë për të adresuar sfidat në infrastrukturë apo shërbime. Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira me vendet fqinje mund të jenë të dobishme për të ndarë përvojën dhe për të zhvilluar strategji të përbashkëta për të përballuar problemet jo vetëm infrastrukturore.

Përveç infrastrukturës rrugore, është e nevojshme të përmirësohet edhe infrastruktura e akomodimit dhe e shërbimeve. Numri i hoteleve dhe i strukturave të tjera akomoduese duhet të rritet për të përballuar

numrin e madh të turistëve. Sipas kreut të shoqatës shqiptare të hoteleri-turizmit Zak Topuzi në vitin 2023, 75% e hoteleve vuanin nga mungesa e punëtorëve, krizë e cila pritet ende të thellohet pasi numri i bizneseve është dyfishuar.

Është e rëndësishme të sigurohet që këto struktura të ofrojnë shërbime cilësore dhe të plotësojnë standardet ndërkombëtare. Investimet në teknologji dhe inovacion mund të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe në rritjen e eksperiencës pozitive të turistëve.

2. "LUFTA" ME MENAXHIMIN E MBETJEVE

Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit Mirela Kumbaro në një takim me prefektët e 12 qarqeve të vendit për t'u komunikuar prioritetet mbi mbarëvajtjen e sezonit veror 2024 ndër të tjerash theksoi se lufta më e madhe këtë vit do të jetë me pastërtinë dhe menaxhimin e mbetjeve, por (të paktën) përgjatë dhjetëvjecarit të fundit sfida e vazhdueshme me numrin në rritje të mbetjeve mbetet një nga luftërat e pafituara. Pavarësisht masave të supozuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për këtë vit duke përfshirë mbështetjen e 8 bashkive bregdetare me operatorë shtesë pastrimi, ngritjen e një Task Force në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për kontrollin e menaxhimit të ujërave të ndotura dhe për të përmirësuar cilësinë e ujërave në plazhe, certifikimin e detyrueshëm të operatorëve turistikë detarë dhe prezenca e vrojtuesve në çdo stacion plazhi rritja e numrit të turistëve ka sjellë një rritje të nivelit të ndotjes në destinacionet turistike, veçanërisht në plazhe dhe zonat e mbrojtura. Kjo kërkon masa të menjëhershme për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve dhe për të siguruar një turizëm të qëndrueshëm. Autoritetet duhet të zhvillojnë strategji për reduktimin e mbetjeve, rritjen e riciklimit dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme në sektorin e turizmit.

Nga vende jo vetëm të Ballkanit, ka pasur përpjekje të ndryshme për të ulur nivelin e ndotjes gjatë periudhave të verës, duke përdorur strategji të ndryshme të menaxhimit të mbeturinave dhe zhvillimin e

praktikave të qëndrueshme për minimizimin e ndotjes. Disa nga shembujt janë:

1. **Kroacia:** Kroacia ka zhvilluar një program të përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave në plazhe, duke vendosur kosha për mbetjet në vende të caktuara, duke organizuar fushata ndërgjegjësuese për të përdorur koshat e plehrave, dhe duke përdorur ekipe të posacme për të pastruar plazhet në mënyrë të rregullt.
2. **Greqia:** Në Greqi, autoritetet kanë hartuar ligje dhe rregullore për të kufizuar përdorimin e plastikës dhe për të promovuar riciklimin. Në disa destinacione turistike, janë vendosur taksa për përdorimin e këtyre materialeve dhe janë zhvilluar fushata sensibilizuese për turistët dhe bizneset lokale.
3. **Maqedonia e Veriut:** Maqedonia e Veriut ka investuar në infrastrukturë për trajtimin e mbetjeve dhe për të përmirësuar sistemin e riciklimit. Ata kanë ndertuar sisteme të riciklimit në zonat turistike dhe kanë organizuar fushata të sensibilizimit për të nxitur komunitetin dhe turistët për të përdorur këto burime në mënyrë efektive.
4. **Mali i Zi:** Mali i Zi ka ndërmarrë masa për të reduktuar përdorimin e plastikës në zonat bregdetare, duke ndaluar përdorimin e qeseve plastike dhe duke vendosur kufizime për shpërndarjen e shisheve plastike. Ata gjithashtu kanë organizuar aksione të pastrimit të plazheve dhe kanë përdorur politika sociale për të përfshirë komunitetin në këtë përpjekje.

Këto shembuj tregojnë se masa të ndryshme duhet të merren për të ulur nivelin e ndotjes gjatë periudhave të verës, duke përdorur strategji efikase të menaxhimit të mbetjeve dhe duke promovuar praktika të qëndrueshme mjedisore.

Përgjatë të paktën 3 viteve të fundit qeveria ka theksuar shpeshherë se fokusi i sezoneve turistike do jetë menaxhimi i mbetjeve që nga viti në vit mbetet një problematikë e pazgjidhur.

Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave gjatë sezoneve turistike është një sfidë e madhe për Shqipërinë, por përvojat e vendeve të tjera tregojnë se me strategji të përshtatshme dhe bashkëpunim të mirëfilltë, është e mundur të arrihet një progres i konsiderueshëm në këtë drejtim. Zbatimi i politikave të mira të riciklimit dhe ndërgjegjësimi i komunitetit të turistëve dhe qytetarëve janë çelësi për të arritur një menaxhim më të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm të mbeturinave në sezonin turistik. Përvojat e suksesshme të vendeve të tjera tregojnë se investimi në riciklimin e mbetjeve dhe promovimi i kulturës së riciklimit mund të rezultojë i suksesshëm në menaxhimin e mbeturinave gjatë sezoneve turistike dhe për vendin tonë Implementimi i taksave mbi mbeturinat dhe rimbursimi për përdorimin e paketimit të riciklueshëm, zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere dhe edukimit për të nxitur përdorimin e materialeve të riciklimit; investimi në ndërtimin dhe përmirësimin e "infrastrukturës" për trajtimin e mbeturinave. përdorimi i legjislacionit për të ndaluar përdorimin e plastikës në zonat turistike si dhe bashkëpunimi i ngushtë mes qeverisë dhe sektorit privat për të zhvilluar programe të përbashkëta për mbledhjen dhe riciklimin e mbeturinave mund të jenë disa iniciativa dobiprurëse lidhur me minimizimin e kësaj problematike.

Përvojat e vendeve të tjera tregojnë se me strategji të përshtatshme dhe bashkëpunim të mirëfilltë, është e mundur të arrihet një progres i konsiderueshëm në këtë drejtim. Zbatimi i politikave të mira të riciklimit dhe ndërgjegjësimi turistëve dhe qytetarëve janë çelësi për të arritur një menaxhim më të qëndrueshëm të mbetjeve në sezonin turistik.

3. NDRYSHIMET LEGJISLATIVE LIDHUR ME LIGJIN PER TURIZMIN.

Ligji Nr. 93/2015 për Turizmin, i ndryshuar me Ligjin Nr. 30/2024, ka për qëllim të rregullojë sektorin e turizmit në Shqipëri dhe të promovojë zhvillimin e tij në mënyrë të qëndrueshme. Megjithatë, disa aspekte të këtij ligji duket se krijojnë hapësira për diskutim për shkak të disproporcionalitetit të tatimeve dhe politikave të favorizimit të turizmit të qëndrueshëm.

Një problem potencial me këtë ligj është taksimi i shtëpive me qira në zonat turistike, në krahasim me hotelet dhe resortet. Nëse tatimi i këtyre shtëpive është më i lartë se tatimi për hotelet dhe resortet, kjo mund të krijojë një barrë të panevojshme për pronarët e shtëpive që ofrojnë akomodime për turistët. Kjo politikë e taksimit mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e sektorit të bizneseve të vogla familjare dhe në konkurrencën e drejtë në mes të bizneseve të ndryshme.

Një tjetër çështje e diskutueshme është përjashtimi për 10 vjet nga tatimi i fitimit dhe tatimi i ulët i TVSH për furnizimin e strukturave akomoduese të mëdha, si hotelet dhe resortet me 4-5 yje. Në vetvete kjo politikë shkakton favorizim të investitorëve të mëdhenj dhe mosrespektim të kushteve të barabarta për të gjithë aktorët në tregun e turizmit.

Analiza e efekteve të politikave fiskale dhe tatimore në sektorin e turizmit është një aspekt shumë i rëndësishëm për të kuptuar si rregullimet ligjore dhe tatimore mund të ndikojnë në zhvillimin dhe funksionimin e këtij sektori të rëndësishëm ekonomik. Në shumicën e vendeve, politikat fiskale përfshijnë tatime të ndryshme mbi shërbimet e akomodimit, siç janë hotelet, resortet, dhe shtëpitë me qira. Në rastin e Shqipërisë, diskutimi për nivelin e tatimit mbi shtëpitë me qira në krahasim me ato të hoteleve dhe resorteve është një çështje e diskutueshme. Nëse shtëpitë me qira taten më lartë sesa hotelet dhe resortet, kjo mund të ndikojë në strukturën e çmimit, duke e bërë më të vështirë konkurrencën për pronarët e shtëpive private dhe duke krijuar një avantazh të padrejtë për strukturat më të mëdha dhe të

institucionalizuara. Një tatim më i ulët për shtëpitë me qira mund të ndihmonte në promovimin e turizmit të qëndrueshëm dhe në rritjen e diversitetit të oferta turistike. Politikat fiskale përfshijnë shpesh stimuj dhe përjashtime tatimore për investitorët që shpenzojnë në zhvillimin e strukturave të mëdha akomoduese, siç janë hoteli dhe resortet me 4-5 yje. Nëse këto stimuj janë të lartë ose janë të fokusuar vetëm në investitorët e mëdhenj, ato mund të shkaktojnë disbalanca në treg dhe të favorizojnë zhvillimin e qëndrueshëm të investitorëve të mëdhenj në dëm të bizneseve të vogla dhe familjare. Një qasje e balancuar do të kërkonte që stimujt të jenë të disponueshëm për të gjithë aktorët në treg, duke përfshirë dhe mbështetur bizneset e vogla dhe të mesme që ofrojnë shërbime turistike.

Një politikë tatimore e padrejtë mund të rrisë kostot për operatorët e vogël dhe të krijojë një barrierë për hyrjen e re në treg për investitorët e rinj. Kjo mund të çojë në një dominim të tregut nga disa lojtarë të mëdhenj dhe në një mungesë të diversitetit dhe inovacionit në ofertën turistike. Politikat fiskale duhet të rregullohen me kujdes për të siguruar një konkurrencë të drejtë dhe për të promovuar një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të turizmit. Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të barabartë të sektorit të turizmit, është e rëndësishme që politikat fiskale të përputhen me nevojat dhe synimet e të gjithë aktorëve në treg. Kjo përfshin monitorimin e efekteve të politikave të ndryshme dhe përmirësimin e tyre në bazë të rezultateve dhe feedback-ut nga industritë e ndryshme të turizmit.

Qeveria shpesh përdor stimuj fiskalë për të tërhequr investime të mëdha që mund të kenë një ndikim të gjerë ekonomik, duke krijuar vende pune dhe duke rritur të ardhurat nga turizmi. Megjithatë, këto stimuj mund të kenë efekte anësore negative, siç është favorizimi i investitorëve të mëdhenj në dëm të atyre më të vegjël.

Shumë vende të BE-së kanë vendosur politika të balancuara që inkurajojnë zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe mbështesin bizneset e vogla dhe të mesme. **Për shembull, Spanja dhe Italia** kanë programe që ofrojnë grante dhe kredi me interesa të ulëta për bizneset e vogla të turizmit, duke siguruar që ato të mund të konkurojnë me sukses me strukturat më të mëdha akomoduese.

Në Greqi, qeveria ka zbatuar politika që mbështesin zhvillimin e turizmit rural dhe agroturizmit, duke ofruar përfitime tatimore dhe subvencione për fermerët dhe pronarët e shtëpive rurale që ofrojnë shërbime turistike. Kjo ka ndihmuar në shpërndarjen e përfitimeve të turizmit në zonat rurale dhe në rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit të turizmit.

Në Francë, përjashtimet tatimore dhe subvencionet për bizneset e vogla janë të kombinuara me rregullore strikte që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo politikë e balancuar ndihmon në krijimin e një mjedisi të barabartë konkurrence dhe promovon zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të turizmit.

Disa aspekte të këtij ligji, (mbështetur dhe në ndryshimet e fundit) veçanërisht në lidhje me tatimin dhe përjashtimet fiskale, mund të krijojnë disbalanca dhe të favorizojnë investitorët e mëdhenj në dëm të bizneseve të vogla. Për të adresuar këto çështje, është e rëndësishme që qeveria të krijojë një kornizë të barabartë fiskale dhe të mbështesë të gjitha llojet e bizneseve në sektorin e turizmit, duke mësuar nga praktikatat e suksesshme të vendeve të tjera dhe të BE-së. Për të rritur besueshmërinë dhe ndikimin e ligjit, është e nevojshme të kemi politika të qarta dhe transparente që përputhen me synimet dhe nevojat e sektorit të turizmit.

GJETJET KRYESORE

1. Qeveria parashikon një rritje prej 60% në numrin e turistëve për vitin 2024 krahasuar me 2023 , nga të dhënat e përlogaritura rritja e konstatuar është 30%.
2. Vetëm 20% e vijës bregdetare e shfrytëzuar ndërkohë shumë potencial turistik i pazhvilluar.
3. Rritja e numrit të turistëve ka sjellë rritje të nivelit të ndotjes, duke rritur nevojën imediate për shtimin e masave për menaxhimin e mbetjeve dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme, problematikë e cila vazhdon ndër vite pavarësisht propagandës së vazhdueshme politike lidhur me hartimin e strategjive specifike për trajtimin e mbetjeve gjatë sezonit turistik, por jo vetëm.
4. Ligji i ri për turizmin synon rregullimin e sektorit, por ka dritëhije mbi taksat dhe stimujt fiskalë që favorizojnë investitorët e mëdhenj në dëm të atyre të vegjël.
5. Disproporcionaliteti në tatimet e shtëpive me qira krahasuar me hotelet dhe resortet; Ligji ka përcaktuar një nivel tatimi më të lartë për shtëpitë me qira në zonat turistike në krahasim me tatimin e hoteleve dhe resorteve. Kjo mund të krijojë një barrë të panevojshme financiare për pronarët e shtëpive private, duke u bërë më të vështirë për ta konkurrencën me strukturat më të mëdha dhe të institucionalizuara.

REKOMANDIMET

1. Rishqyrtimi i Politikave Tatimore dhe Stimujve Fiskalë:

Është e rëndësishme që qeveria të rishqyrtojë nivelin e tatimeve për shtëpitë me qira në zonat turistike në krahasim me hotelet dhe resortet. Një rishikim i nivelit të tatimit për shtëpitë me qira mund të ndihmonte në zvogëlimin e disproporcionalitetit dhe në përmirësimin e konkurrencës së drejtë në mes të strukturave të ndryshme akomoduese.

2. Zhvillimi i Potencialit Turistik të Pazhvilluar:

Qeveria duhet të përqendrohet në zhvillimin e zonave turistike të pazhvilluara, duke përfshirë vijën bregdetare. Investimet në infrastrukturë dhe mbështetje për bizneset lokale mund të ndihmojnë në përdorimin më efektiv të resurseve turistike të vendit.

3. Menaxhimi i Ndotjes dhe Trajtimi i Mbetjeve:

Rritja e numrit të turistëve ka sjellë një rritje të nivelit të ndotjes. Është kritike që qeveria të shtojë masat për menaxhimin e mbetjeve dhe të promovojë praktika të qëndrueshme në sektorin e turizmit. Kjo përfshin investime në infrastrukturë për trajtimin e mbetjeve dhe edukim të turistëve dhe operatorëve turistikë për rregullat e mbrojtjes së mjedisit.

4. Promovimi i Turizmit të Qëndrueshëm dhe Inkurajimi i Diversifikimit të Ofertës Turistike:

Qeveria duhet të inkurajojë praktika të qëndrueshme në turizëm, duke përfshirë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e burimeve të qëndrueshme dhe diversifikimin e ofertës turistike për tërheqjen e një bazë turistike të gjerë dhe të përhershme.

5. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar:

Bashkëpunimi me vendet fqinje për ndarjen e përvojave dhe zhvillimin e strategjive të përbashkëta për përmirësimin e sektorit të turizmit. Zbatimi i praktikave të mira nga vendet e tjera për të adresuar sfidat në infrastrukturë dhe shërbime.

BIBLIOGRAFIA

- MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT (<https://turizmi.gov.al/janari-2024-solli-30-me-shume-turiste-te-huaj-se-nje-vit-me-pare/>)
- Kumbaro takim me prefektët në prag të sezonit veror/
Tolerancë zero për struktura betoni në plazhe, mobilizim dhe monitorim- MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
(<https://turizmi.gov.al/kumbaro-takim-me-prefektet-ne-prag-te-sezonit-veror-tolerance-zero-per-struktura-betoni-ne-plazhe-mobilizim-dhe-monitorim/>)
- Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri-INSTAT
- (<https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/statistikat-e-turizmit/>)
- Opinion - Çfarë turizmi po bëjmë?
(<https://youtu.be/8RI1aBqCQIM?feature=shared>)
- Turizmi në Shqipëri, një propagandë e qeverisë?
(<https://youtu.be/2dOn7ZNWfCg?feature=shared>)
- Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 93/2015, "Për turizmin", i ndryshuar; <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/04/04/30/f1996dd4-ca24-4965-b8b1-200179ca0659>

#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NUOVA
EUROPA
PER
L'ITALIA

EUROPEAN UNION

www.qeverisja.qg.com.al